

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ICOFENIX CORPORATION LTD” sh.p.k



Sot në datën 21.10.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), unë **Claudio Marco Migliavacca**, atësia Luigi, datëlindja 28.05.1951, lindur në Paderno Dugano, Itali banues në Itali, Via Volta, 23, MontiCelo Brianza, Provinca Leco titullar i pasaportës me nr. YA6872593, lëshuar nga autoritetet italiane në datën 21.08.2014, vendosa të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar, **“ICOFENIX CORPORATION LTD” sh.p.k**, mbështetur në nenin 2 paragrafi „B“ i Ligjit „Për sanksionet dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë të veprimtarisë private, të pavarur dhe të privatizimit“, në ligjin 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” I ndryshuar në të cilën jam Ortak i Vetëm dhe për këtë qëllim hartoj Aktin e Themelimit, me përmbajtjen si vijon:

NENI 1
EMRI

Shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar emërtohet **“ICOFENIX CORPORATION LTD” sh.p.k**, e cila këtu më poshtë do të quhet “Shoqëria”.

NENI 2
FORMA

2.1 Kjo shoqëri është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar .

NENI 3
BAZA JURIDIKE

3.1 Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 4
SELIA

4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në rrugën “Thanas Ziko”, pall. 64/6.
4.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 5
TERRITORI

5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj. Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

Aktivitet në fushën e ekologjisë, për industrinë

Konsulence, ekonomike, financiare, manaxheriale, shitjeje, konsulencë për kredimarrje në sistemin bankar shqiptar, hartim plani biznesi, studim tregu, konsulencë marketing dhe promovim aktiviteti të subjekteve, konsulencë në burimet njerëzore, shërbime përfaqësimi ndaj subjekteve dhe individëve, vendas apo të huaj, ndërmjetësim financiar dhe trajnime etj., për bizneset dhe individët, si dhe çdo shërbim financiar dhe kontabël të lejuar nga legjislacioni shqiptar për këtë lloj shoqërie që ka lidhje me këtë object veprimtarie.

KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193399

Import eksport tregeti me shumice e pakice, tregetim te mallrave industriale, ushqimore, fruta perime, piqe te ndryshme alkoolike e freskuese, veshmbathje, materiale ndertimi, pjese kembimi automjete, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetike te perpunuara dhe te paperpunuara, bime medicinale, lende drusore plastike dhe duralumini dhe cdo lloj malli te lejuar nga legjiuslacioni shqiptar per kete lloj shoqerie.

Aktivitet ne fushen e agjensisë imobiliare, shitje blerje pasurish te luajtshme dhe/ose te paluajtshme dhe cdo veprimtari e lidhur me te.

NENI 7 KOHËZGJATJA

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim te ortakut te vetëm.

NENI 8 KAPITALI THEMELTAR

8.1 Kapitali Themeltar i Shoqërisë është **100 000 leke** (njëqind mijë). Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga Ortaku i Vetëm.

NENI 9 KONTRIBUTET

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë **Claudio Marco Migliavacca**.

NENI 10 PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR

10.1 Kapitali themeltar është i ndarë në 1 kuotë plotësisht të shlyer.

NENI 11

11.1 **Administrimi** i shoqërisë do të bëhet nga një administrator. Administrator i shoqërisë është **Claudio Marco Migliavacca**, atësia Luigi, datëlindja 28.05.1951, lindur në Paderno Dugano, Itali banues në Itali, Via Volta, 23, MontiCelo Brianza, Provinca Leco titullar i pasaportës me nr. YA6872593, lëshuar nga autoritetet italiane në datën 21.08.2014, lëshuar nga autoritetet italiane në datën 21.08.2014. Ai ushtron këtë detyrë për një periudhë 5 vjet.

NENI 12 DISPOZITA TE FUNDIT

12.2 Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij Akti Themelues edhe me norma te përcaktuara në Statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm dhe si i tillë do të miratohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ditën e legalizimit si person juridik në Shqipëri.

12.3 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

THEMELUESI Claudio Marco Migliavacca

I pranishëm përkthyesi Klodian Kovaci, datëlindja 10.09.1980, lindur në Shkodër, titullar i letërnjoftimit me nr. 027164397, i regjistruar me nr. personal I00910100W

KLODIAN KOVACI
PERKTHYES I BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193399

Claudio Marco Migliavacca
Migliavacca



**STATUTI
I
SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“ICOFENIX CORPORATION LTD” sh.p.k

EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

**NENI 1
EMRI**

Në Tiranë, sot më 21.10.2019, krijohet shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“ICOFENIX CORPORATION LTD” sh.p.k**, e cila këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”. Ajo krijohet nga ortakut i vetëm themeluesi **Claudio Marco Migliavacca**, atësia Luigi, datëlindja 28.05.1951, lindur në Paderno Dugano, Itali banues në Itali, Via Volta, 23, Monticelo Brianza, Provincia Leco titullar i pasaportës me nr. YA6872593, lëshuar nga autoritetet italiane në datën 21.08.2014, vendosa të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar, **“ICOFENIX CORPORATION LTD” sh.p.k**, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar.

**NENI 2
FORMA**

2.1 Kjo shoqëri është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3
BAZA JURIDIKE**

3.1 Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 4
SELIA**

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, “Thanas Ziko”, pall. 64/6 dhe mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.

**NENI 5
TERRITORI**

5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj. Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

**NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

Aktivitet në fushën e ekologjisë, për industrinë.

Konsulencë, ekonomike, financiare, manaxheriale, shitjeje, konsulencë për kredimarrje në sistemin bankar shqiptar, hartim plani biznesi, studim tregu, konsulencë marketing dhe promovim aktiviteti të subjekteve, konsulencë në burimet njerëzore, shërbime përfaqësimi ndaj subjekteve dhe individëve, vendas apo të huaj, ndërmjetesim financiar dhe trajnime etj., për bizneset dhe individët, si dhe çdo shërbim financiar dhe kontabël të lejuar nga legjislacioni shqiptar për këtë lloj shoqërie që ka lidhje me këtë objekt veprimtarie.

KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193399

Import eksport tregeti me shumice e pakice, tregetim te mallrave industriale, ushqimore, fruta perime, pije te ndryshme alkoolike e freskuese, veshmbathje, materiale ndertimi, pjese kembimi automjete, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetike te perpunuara dhe te paperpunuara, bimë medicinale, lende drusore plastike dhe duralumini dhe cdo lloj malli te lejuar nga legjislacioni shqiptar per ketë lloj shoqërie.

Aktivitet në fushën e agjensisë imobiliare, shitje blerje pasurish të luajtshme dhe/ose të paluajtshme dhe cdo veprimtari e lidhur me të.

NENI 7 KOHËZGJATJA

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

KAPITULLI III AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI

NENI 8 FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT

8.1 Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose e humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë si dhe kompetencat që gëzon ortakut në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

NENI 9 LIBRI I SHOQËRISË

9.1 Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

NENI 10 KONFIDENCIALITETI

10.1 Ortaku i vetëm si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që disponon Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj material, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 11 DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT

11.1 Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxirren nga shoqëria dhe janë të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet, publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "SH.P.K", si dhe emrin e administratorit.

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT DHE TRANSFERIMI I TYRE

NENI 12 KAPITALI THEMELTAR


12.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë.

12.2 Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakut i vetëm. Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin, në varësi të nevojave dhe rezultateve të saj, sipas vendimit të ortakut të vetëm.

NENI 13 KONTRIBUTET

13.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë Claudio Marco Migliavacca në vlerën 100 000 Lekë.


KLOBIAN KOVACI
PERKTHYES I BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193399

 2



NENI 14 PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR

14.1 Kapitali themeltar është i ndarë në 1 kuotë plotësisht të shlyer.

NENI 15 LËNIA DHE TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

15.1 Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë, në qoftë se ortaku i vetëm vendos për këtë. Ai mund të lihet peng sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu kapitali themeltar është i transferueshëm në rrugë trashëgimie. Bashkëshortja, paraardhësit dhe pasardhësit mund të bëhen ortakë nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar, me vendim të ortakut të vetëm dhe sipas kushteve që lejohen me ligj. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me një akt noterial.

ORGANI DREJTUES

NENI 16 ORTAKU I VETËM

16.1 Ortaku i Vetëm ushtron i vetëm të gjitha kompetencat që i njihen me ligj për shkak të kësaj cilësie.

NENI 17 KOMPETENCAT E ORTAKUT TË VETËM

17.1 Për sa kohë që Shoqëria do të përbëhet nga një ortak i vetëm, kompetencat e tij do të jenë:

- Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqërinë apo për sektorë të veçante të veprimtarisë.
- Vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit dhe transferimin e pjesëve të kapitalit.
- Vendos për politikën afariste të Shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj.
- Emëron dhe shkarkon administratorët e Shoqërisë dhe detajon kompetencat e tyre të percaktuara në statut dhe sipas rastit Ekspertin Kontabël.
- Shqyrton bilancin vjetor, përcakton llojet e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos për marrjen e kredive.
- Vendos për krijimin e degëve (filialeve) ose të përfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive me persona të tjerë fizikë apo juridikë.
- Vendos për marrëdhëniet me të rëndësishme ekonomike dhe financiare të Shoqërisë me persona të tjerë fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj.
- Vendos për mbarimin e Shoqërisë, likuidimin e saj si dhe për shndërrimin e Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera.
- Vendos çmimet e mallrave.
- Vendos për pagat e të punësuarve në Shoqëri.

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 18 ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

18.1 Kompetencat e administratorit ose të administratorëve, në mënyrë konkrete dhe të detajuar përcaktohen në aktin e tyre të emërimit. Veç të tjerave që mund të detajohen në këtë akt, administratori ka edhe këto kompetenca:

- Realizon administrimin, drejtimin dhe përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhëniet me persona të tjerë juridikë apo fizikë.
- Kujdeset për funksionimin e përditshëm normal të Shoqërisë ose të një pjese të aktivitetit ekonomik dhe financiar të saj, sipas përcaktimit në aktin e emërimit.

KLODIAN KOVACI
PERKTHYES I BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193333

- Përgatit, dokumentacionin dhe raportet e ndryshme për gjendjen ekonomike dhe financiare të Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe ia paraqet Ortakut të Vetëm për shqyrtim.
- Koordinon veprimtarinë e personave të punësuar në Shoqëri.
- Shqyrton ofertat dhe përgatit kërkesa të cilat ia paraqet Ortakut të Vetëm për miratim.
- Ndjek problemet e Shoqërisë në marrëdhënie me organet shtetërore ose cakton ndonjë prej personelit për trajtimin e këtyre problemeve.
- I propozon Ortakut të Vetëm të Shoqërisë çmimet e mallrave, si dhe pagat për personelin e punësuar në Shoqëri.
- I propozon Ortakut të Vetëm rregulloret për sektorë të veçantë të Shoqërisë.

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.

Kompetencat e administratorit janë të pakufizuara.

LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDENTET

NENI 19

LIBRAT E SHOQËRISË

19.1 Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç Librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut, kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut të vetëm edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

NENI 20

BILANCI

20.1 Viti financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti.

20.2 Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga ortaku i vetëm.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 21

DIVIDENTET

21.1 Ortaku i vetëm miraton llogaritë vjetore dhe evidenton ekzistencën e fitimit. Ai përcakton fitimin e vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjane për: rezervën sipas ligjit ose të përcaktuar nga vetë ortaku; fondet e tjera që shihen të nevojshme dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme. Kështu ortaku i vetëm përcakton dhe dividendin.

MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

NENI 22

MBARIMI

22.1 Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

NENI 23

LIKUJDIMI

23.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimin që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimin dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likujdimin, ortaku i vetëm vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimin. Mbas pagimit të kreditorëve ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193399



MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA E FUNDIT

NENI 24

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

24.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

NENI 25

DISPOZITA E FUNDIT

25.1 Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.

25.2 Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e së cilës do të përcaktohen nga Ortaku i Vetëm.

25.3 Administratori i shoqërisë është z. **Claudio Marco Migliavacca**, atësia Luigi, datëlindja 28.05.1951, lindur në Paderno Dugano, Itali banues në Itali, Via Volta, 23, Monticelo Brianza, Provincia Leco titullar i pasaportës me nr. YA6872593, lëshuar nga autoritetet italiane në datën 21.08.2014, lëshuar nga autoritetet italiane në datën 21.08.2014

Ai qëndron në këtë detyrë për një periudhë 5 vjet.

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKU I VETËM

Claudio Marco Migliavacca

I pranishëm përkthyesi Klodian Kovaçi, datëlindja 10.09.1980, lindur në Shkodër, titullar i letërnjoftimit me nr. 027164397, i regjistruar me nr. personal I00910100W

KLODIAN KOVACI
PERKTHYESI BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193399

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NR 359 REP
NOTERE: DHIMITRA QARRI



taksa u likujdua

Adresa: Blv. "Bajram Curri", pall. "1 Maji", sh. 3, ap. 24, përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
Tel: 0692095571/0697306457, e-mail: dhqarri@yahoo.com

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Në Tiranë, sot më datë 21.10.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), para meje noteres publike **Dhimitra Qarri**, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë noteriale, në Blv. "Bajram Curri", pallatet "1 Maji", shk. 3, ap 24, u paraqit personalisht shtetas:

Klodian Kovaçi, atësia Petrit, datëlindja 10.09.1980, lindur në Shkodër, banues në Tiranë, rr "Dibrës", kompleksi "Orion", hyrja 1/13, titullar i letërnjoftimit me nr. 027164397, i regjistruar me nr. personal I00910100W, i martuar, përkthyes zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë për gjuhën italiane, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, i cili me vullnet të lirë, të plotë e të pavesuar, deklaroi se deklaroi se u ka përkthyer fjalë për fjalë aktin e themelimit dhe statutin bashkalidhur, shtetasve të huaj, **Claudio Marco Migliavacca** nga gjuha shqipe në atë italiane dhe anasjellas, e nënshkruan në praninë time dhe unë noterja e vërtetoj nënshkrimin në bazë të nenit 128, të ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 „Për Noterinë“.

NOTERE

Dhimitra Qarri